



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:170671  
Datë: 11.01.2024  
Numri i dokumentit: 05178911

**PA1.nr.1626/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Mehmet Ndrecaj, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit G.K., nga fshati ..., K. Kamenicë, për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-se, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtësit se të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.129/2019 të datës 01.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04 Janar 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e mbrojtësit të akuzuarit G.K., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.129/2019 të datës 01.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.129/2019 të datës 01.11.2023, i akuzuari G.K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-se, për të cilën është shqiptuar denimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 ( një ) viti me kusht se ky enim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afat prej 2 ( dy ) viteve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër vepër penale.

Gjithashtu, te akuzuarit i eshte shqiptuar edhe denimi plotesues, ku i eshte konfiskuar arma e llojit Ecol special, me afer e pershkruar ne faqen 2 te aktgjykimit te ankimuar te Gjykates se shkalles se pare.

I akuzuari eshte obliguar qe te paguaje shpenzimet e procedures penale qe dalin sipas llogarise perfundimtare te gjykates, ne emer te paushallit gjyqesor shumen prej 50 ( pesëdhjetë ) euro, ne emer te fondit per kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 50 ( pesëdhjetë ) euro, e te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se aktgjykimit.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :**

Mbrojttesi i te akuzuarit G.K., av.Rrustem Latifaj nga Gjilani, per shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit per vepren penale per te cilen eshte shpallur fajtor te i shqiptohet dënim dukshem me i ulet me burgim të kushtëzuar dhe periudhën e verifikimit më të ulët se sa denimi i shqiptuar nga ana e Gjykates se shkalles se pare, e me te cilin dënim do te arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesen e mbrojtetit te akuzuarit G.K., me shkresën e vet PPA.II.nr. 661/2023 të datës 21.12.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesen e mbrotjesit te akuzuarit ta refuzoje si te pabazuar, ndersa aktgjykimi i ankimuar i Gjykates se shkalles se pare te vertetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, per te cilen nuk i ftoi palet ngase ne rastin konkret kemi te bejme me denim me burgim të kushtëzuar dhe pretendimet ankimore jane vetem lidhur me sanksionin penal andaj prezenca e paleve nuk eshte e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te mbrojtetit te akuzuarit, dhe gjeti se:

#### **- Ankesa nuk eshte e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njejtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 24.10.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për vepren penale për të cilen eshte akuzuar, i cili pranim eshte bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas konsultimit te mjaftueshem me mbrojtetin e tij. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojttesi i te akuzuarit G.K. – Av.Rrustem Latifaj, me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te dënimit me burgim të kushtëzuar, nuk i ka vleresuar drejte dhe ne menyre te duhur

rrethanat lehtësuese si faktin se i akuzuari ne fazat e hershme te procedures e ka pranuar fajesine per vepren penale te kryer, ka shprehur keqardhje, ka premtuar se ne te ardhmen nuk do te kryeje vepra penale, se me pare nuk ka rene ne kundershtim me ligjin, e sikur keto rrethana te ishin vleresuar ne menyre te duhur eshte dashur qe te akuzuarit te i shqiptohet nje denim dukeshem me i ulet me burgim te kushtëzuar se sa denimi i shqiptuar nga ana e Gjykates se shkalles se pare dhe periudhë verifikimi më të shkurtër e me te cilin denim do te arrihej qellimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se, andaj ka propozuar qe ankesa e mbrojtetit te akuzuarit te aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosoves, vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me sanksionin penal te mbrojtetit te akuzuarit per shqiptimin e denimit me te ulet me burgim te kushtëzuar dhe periudhë verifikimi më të shkurtër, dhe pas vlerësimit te njejtës, dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkalles se pare drejte dhe ne menyre te plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 te KPRK-se te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se denimi i shqiptuar me burgim të kushtëzuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykates se shkallës së parë eshte në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të vepres penale të kryer, andaj e refuzoi si te pabazuar ankesen e mbrojtetit te akuzuarit, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykates se shkalles se pare, e me bindje se me denimin e shqiptuar nga ana e Gjykates se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1626/23 më 04.01.2024**

**Procesmbajtësi**  
**Arben Arifi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit**  
**Skender Çoçaj**

---

**Mehmet Ndrecaj**

---